

BULETINI



KOMUNA E LIPJANIT
JANAR 2026

MIRATOHET BUXHETI I KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2026

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur, ka miratuar Buxhetin për periudhën 2026–2028, me 16 vota për dhe 15 vota kundër.

Mbledhja u zhvillua nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit, z. Daut Azemi, ndërsa në seancë ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me përfaqësues të tjerë të ekzekutivit.

Gjatë seancës u prezantua propozim-vendimi mbi aprovimin e buxhetit nga Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, duke paraqitur planifikimin financiar të komunës për tri vitet e ardhshme. Pas diskutimeve nga anëtarët e Kuvendit, propozimi u hodh në votim dhe u miratua me shumicë të thjeshtë.

Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti, theksoi se buxheti është hartuar duke u bazuar në kapacitetet reale financiare të komunës, me fokus në prioritetet kryesore dhe në përmbushjen e nevojave më të rëndësishme të qytetarëve të Lipjanit.

Miratimi i Buxhetit për vitet 2026–2028 krijon bazën financiare për planifikimin dhe zbatimin e projekteve zhvillimore, ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjeteve komunale në vitet në vijim.



KPF MBAN MBLEDHJEN E PARË

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e parë, gjatë së cilës është shqyrtuar dhe diskutuar pika e rendit të ditës e propozuar për këtë mbledhje.

Gjatë këtij takimi, drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, ka prezantuar para anëtarëve të KPF-së Propozim-Buxhetin e Komunës së Lipjanit për periudhën 2026–2028.

Pas diskutimeve anëtarët e KPF-së kanë rekomanduar pikën përkatëse të rendit të ditës për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të premten, më 9 janar 2026.



NDEROHET ME HOMAZHE HEROI ISMAIL LUMA-ALTINI

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, me rastin e 27-vjetorit të rënies heroike të Ismail Luma-Altinit, bëri homazhe dhe vendosi buqeta me lule pranë lapidarit të heroit, në shkollën "Ismail Luma", si shenjë respekti dhe mirënjohjeje për veprën e tij të pavdekshme.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se sakrifica sublime e dëshmorëve, në mesin e tyre edhe Ismail Luma-Altini, ka ndërtuar themelet e lirisë dhe të shtetësisë sonë, ndërsa respekti dhe përkujtimi për ta janë të shenjta dhe do të mbeten përherë të gjalla në kujtesën tonë kolektive.

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve!



KRYETARI IMRI AHMETI MBAN MBLEDHJEN E PARË ME BORDIN E DREJTORËVE TË EMËRUAR SË FUNDMI

Në fillim të këtij takimi Kryetari Imri Ahmeti ka uruar drejtorët e rinj për detyrën dhe në të njëjtën kohë ka kërkuar edhe përkushtimin e tyre në ngritjen e mëtejshme të shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike.

Kryetari Ahmeti, po ashtu ka ndarë pikat kryesore të planit të punës për vitin aktual, duke vënë theks të veçantë në projektet që synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Gjithashtu gjatë këtij takimi u diskutuan shumë çështje që kanë të bëjnë me realizimin e projekteve kornizë, por edhe atyre të planifikuara për këtë vit, si dhe është diskutuar edhe për bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me fokus në aplikimin për grante dhe bashkëfinancim në investime të ndryshme në Lipjan.



KRYETARI AHMETI VIZITON SHFMU "ISMAIL LUMA" PAS RIKTHIMIT TË PROCESIT TË RREGULLT MËSIMOR

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vizituar Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Ismail Luma", e cila së fundmi është përballur me përmbytje si pasojë e reshjeve të shumta që kanë prekur edhe komunën tonë.

Gjatë vizitës, Kryetari Ahmeti u informua nga afër për gjendjen në shkollë dhe për masat e ndërmarra për rikthimin e shpejtë të procesit të rregullt mësimor.

Me këtë rast, ai ka falënderuar Drejtorin e shkollës, z. Driton Sadiku, si dhe Drejtorin e DKA-së, z. Rasim Hasani, për reagimin e shpejtë dhe efikas, falë të cilëve objekti shkollor u pastrua në kohë rekord dhe mësimi u rikthye menjëherë në procesin e rregullt.

Kryetari Ahmeti theksoi rëndësinë e bashkëpunimit institucional në situata emergjente dhe ritheksoi përkushtimin e Komunës së Lipjanit për të garantuar kushte të sigurta për të gjithë nxënësit dhe stafin arsimor.



KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA PRITUR NË TAKIM AMBASADORIN E REPUBLIKËS SË SLOVENISË NË KOSOVË, Z. BORUT BLAJ.

Gjatë takimit u theksua bashkëpunimi i ndërsjellë në fusha të ndryshme, veçanërisht në atë të zhvillimit ekonomik dhe në fusha të tjera me interes të përbashkët.

Kryetari Ahmeti e falënderoi Ambasadorin Blaj për vizitën në Lipjan dhe ka shprehur mirënjohjen e tij për kontributin dhe mbështetjen e Sllovenisë ndaj popullit të Kosovës, duke e informuar njëkohësisht për karakteristikat, potencialet dhe prioritetet zhvillimore të Komunës së Lipjanit, si dhe për projektet aktuale që janë në proces të realizimit.

Nga ana tjetër, Ambasadori Blaj e uroi Kryetarin Ahmeti për mandatin e ri, duke shprehur gatishmërinë për një bashkëpunim të ngushtë me Komunën e Lipjanit në të gjitha fushat, veçanërisht në ato kulturore dhe ekonomike.



KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA PRITUR NË TAKIM PËRFAQËSUESIN E MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË, Z. EMIL SAVOV, ME Ç'RAST KANË BISEDUAR LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN E DERITANISHËM QË MISIONI I OSBE-SË KA PASUR ME KOMUNËN E LIPJANIT DHE VAZHDIMIN E KËTIJ BASHKËPUNIMI EDHE NË TË ARDHMEN.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Imri Ahmeti theksoi se Komuna e Lipjanit është mirënjohëse ndaj OSBE-së e cila vazhdimisht ka ofruar mbështetje në promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe ka nënvizuar rëndësinë e vazhimit të bashkëpunimit në të ardhmen.

Ndërsa, Emil Savov nga OSBE-ja uroi Kryetarin Ahmeti për mandatin e ri dhe falënderoi për bashkëpunimin dhe angazhimin e tij për t'i shtyrë të gjitha proceset përpara në të mirën e të gjithë qytetarëve nga Komuna e Lipjanit pa dallim, duke shprehur gatishmërinë e tij dhe të OSBE-së për të vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen me Komunën e Lipjanit.



MBAHET TAKIM MES KOMISIONIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT DHE NIVELIT QENDROR PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Në sallën e Bordit të Komunës së Lipjanit, është mbajtur takim pune ndërmjet Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore të Komunës së Lipjanit dhe përfaqësuesve të komisionit të nivelit qendror.

Gjatë këtij takimi, palët diskutuan në detaje lidhur me dëmet e shkaktuara në territorin e Komunës së Lipjanit, si pasojë e reshjeve të fundit, si dhe për procedurat ligjore dhe institucionale për adresimin dhe kompensimin e këtyre dëmeve.

U theksua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, me qëllim që procesi i vlerësimit të dëmeve të jetë sa më i saktë, transparent dhe në shërbim të qytetarëve të prekur.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar dhe në koordinim me institucionet përkatëse, do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për mbështetjen e qytetarëve dhe për përshejtimin e procesit të vlerësimit të dëmeve në zonat e prekura.



DREJTORI I DKA-SË PRET NË TAKIM NXËNËSIN ADRI VILA PAS SUKSESIT HISTORIK NË SHBA

Drejtori i Arsimit në Komunën e Lipjanit, z. Rasim Hasani, ka pritur në takim nxënësin e dalluar Adri Vila, së bashku me drejtorin e SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, z. Jakup Bahtiri, me rastin e suksesit të jashtëzakonshëm të Adrit në garat ndërkombëtare të shkencës dhe programimit, të mbajtura në Orlando, Florida, SHBA.

Adri Vila, nxënës i klasës së 9-të i SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, arriti të fitojë dy medalje të arta në fushën e biologjisë dhe kodimit, duke u renditur në dy vendet e para në “Coding Olympiad – NEO Science Olympiad 2026”. Ky sukses është një dëshmi e qartë e talentit, përkushtimit dhe punës së palodhur të Adrit, si një ndër nxënësit më të dalluar të Komunës së Lipjanit.

Gjatë takimit, drejtori i DKA-së, z. Rasim Hasani, e përgëzoi Adrin për përfaqësimin dinjitoz të Kosovës dhe për ngritjen e flamurit të Republikës sonë në arenën ndërkombëtare.

“Arritja e Adrit është një sukses që na bën krenarë të gjithëve, jo vetëm Komunën e Lipjanit, por edhe mbarë Kosovën. Ai është shembull se me dije, punë dhe përkushtim, të rinjtë tanë mund të shkëlqejnë kudo në botë. Adri na ka nderuar dhe na ka treguar se e ardhmja jonë është e sigurt në duart e gjeneratave të tilla”, tha drejtori i DKA-së, z. Rasim Hasani.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar në mbështetjen e nxënësve të talentuar, të cilët po arrijnë suksese edhe në arenën ndërkombëtare.



PREZANTOHET RAPORTI VJETOR I STACIONIT TË POLICISË SË KOSOVËS NË LIPJAN PËR VITIN 2025

Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, u prezantua Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës për Stacionin Policor në Lipjan për vitin 2025.

Raportin e prezantoi Komandanti i Stacionit Policor në Lipjan, Kapiten Brahim Shatrolli, i cili theksoi se viti 2025 ka qenë një vit i suksesshëm për Policinë e Kosovës në Lipjan. Ai bëri të ditur se gjatë këtij viti janë raportuar gjithsej 1,267 raste, të cilat janë trajtuar me profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale.

Me këtë rast, Kapiten Shatrolli falënderoi të gjithë zyrtarët policorë për angazhimin e tyre të vazhdueshëm, si dhe institucionet dhe akterët e tjerë relevantë për bashkëpunimin e ngushtë në funksion të rritjes së sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve.

Në këtë takim, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, vlerësoi lart bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Stacionit Policor në Lipjan. Ai falënderoi Policinë e Kosovës për angazhimin dhe kontributin e vazhdueshëm në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, si dhe theksoi rolin e përfaqësuesve të policisë në KKSB, ku përmes bashkëpunimit të ndërsjellë janë adresuar dhe trajtuar me sukses problematika të ndryshme të qytetarëve.



U SHËNUA DITA BOTËRORE E MBULESËS NË AMBIENTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Me rastin e Ditës Botërore të Mbulesës, e cila shënohet në mbarë botën, Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame në Lipjan, organizoi një aktivitet domethënës, duke vënë në pah rëndësinë e mbulesës si simbol i identitetit, dinjitetit, besimit dhe lirisë së zgjedhjes së gruas.

Ky aktivitet shërbeu si një mesazh ndërgjegjësues për respektimin e diversitetit fetar dhe kulturor, si dhe për fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri. Mbulesa nuk është kufizim, por shprehje e bindjes personale dhe e vlerave shpirtërore.

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit dhe institucionet që e mbështetën këtë ngjarje, duke kontribuar në promovimin e tolerancës, respektit dhe bashkëjetesës në shoqërinë tonë.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508